



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planiar / Diturazi Pimljen / Predato Received / Delivry	10-01-2023	3 viti god year	
Organ / Njësia Org / Jednica Org / Unit	Rr / Prot B / Prot Pr / I No	Stip / Prilozh Append	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	147/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.536/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.1938/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 29.11.2021, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.536/2021 të datës 15.06.2021 të parashtruar nga ankuesja

të cilën me autorizim e përfaqëson Avokati

kundër Vendimit

Nr.521/2021 të datës 02.06.2021 dhe Vendimit Nr.540/2021 të datës 04.06.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.536/2021 e datës 15.06.2021 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimin Nr.540/2021 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i datës 04.06.2021.

A r s y e t i m

Ankuesja, e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 15.06.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit Nr.521/2021 të datës 02.06.2021 dhe Vendimit Nr.540/2021 të datës 04.06.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me pretendimet ankimore se vendimet e goditura me këtë ankesë janë në

kundershtim të plotë me legjislacionin për shërbimin civil me kërkesën për kompensimin retroaktiv të pagës prej periudhës kohore kur ankuesja është larguar nga puna.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 18.06.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa me datën 24.06.2021 me numër protokoll 3300/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 29.07.2021 përmes Njoftimit me Nr.Prot:3981/2021, ka njoftuar ankuesen se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.nr.536/2021 të datës 15.06.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 29.11.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1938/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e datës 29.07.2021 të KPMSHCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesve me numër A.nr.536/2021 të datës 15.06.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesa A.nr.536/2021 e datës 15.06.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A.nr. 1938/2021 i datës 29.11.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktvendimin A.nr.157/2019 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 23.09.2021; Vendimin e Këshillit A.nr.640/2018 i datës 23.11.2018; Aktvendimin A.nr.157/2019 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 02.12.2021; Përgjigjen në padi të datës 14.10.2021; Autorizimin e datës 08.06.2021; Vendimin e Zëvendësuesit të Sekretari të Përgjithshëm të MKRS-së i datës 03.02.2021; Vendimin Nr.521/2021 e Zëvendësuesit të Sekretari të Përgjithshëm të MKRS-së i datës 02.06.2021; Vendimin Nr.540/2021 e Zëvendësuesit të Sekretari të Përgjithshëm të MKRS-së i datës 04.06.2021; Vendimin Nr.206/2021 e Zëvendësuesit të Sekretari të Përgjithshëm të MKRS-së i datës 09.03.2021; Vendimin Nr.645/2018 e Sekretari të Përgjithshëm të MKRS-së i datës 03.05.2018; Akt emërimin e datës 16.02.2018 me numër:453/2018; Aktgjykimi e Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda P.Nr.113/17 i datës 17.01.2019; Raportin me Rekomandime i Avokatit të Popullit në rastin Ankesa nr.314/2018 i datës 27.03.2020; Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i datës 18.06.2018 me shifër KZKA Nr.10/2018; Ankesën e ankuesit të datës 10.10.2018 të parashtruar në Këshill; Ankesën e ankuesit të datës 10.10.2018 të parashtruar në Këshill 12.07.2018; Vendimin e Këshillit i datës 10.09.2018 me shifër A.nr.441/2018; Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i datës 26.09.2018 me shifër KZKA Nr.03/2018; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm; E-mailin e datës 04.06.2021 dërguar nga I.A për ankuesen; Kërkesën e ankueses të datës 05.10.2020 dërguar Sekretarit të Përgjithshëm nga ankuesja; Akt emërimin e datës 15.07.2020; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së i datës 10.07.2020 me numër:629/2020; E-mailin e datës 18.01.2021 dërguar nga B.B për Sekretarin e Përgjithshëm me korrespondencën e bashkangjitur; Listën e pagave të ankueses për muajin maj 2021; kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.06.2021; E-mailin e datës 13.08.2021

dërguar nga M.G për Këshillin; Njoftimin e datës 29.07.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 24.06.2021; Akt emërimit e datës 15.07.2020; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektor në Inspektoratin e trashëgimisë Kulturore; Vendimi për emërim i datës 15.03.2018 i Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 03.05.2018 me numër:645/2018; Ankuesën e ankuesit të parashtruar në KZKA të datës 17.05.2018; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së i datës 03.05.2018 me numër:645/2018; E-mailin e datës 02.05.2018 dërguar nga Arkiva e MKRS për ankuesen; Vendimin e datës 10.07.2018 me numër:629/2020 të Sekretarit të Përgjithshëm.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja është përzgjedhur kandidat e suksesshme në procedurën e rekrutimit të zhvilluar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për pozitën: *"Inspektore në inspektoratin për Trashëgimi Kulturore"*, sipas njoftimit të datës 21.12.2017 me numër protokollit 5154/2017-2, dhe të njëjtës i është lëshuar Akt emërimi me numër 453/2018, i datës 16.02.2018.

Më pas, me qëllim të verifikimit të dhëna, në bazë të kërkesës zyrtare, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është njoftuar nga zyrtari përgjegjës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, përmes e-mailit zyrtar, me datë 22.03.2018, se: *"ndaj ankueses shtë duke u zhvilluar procedura penale sipas Aktakuzës PP.I nr.943/15, datë 30.03.2017 për shkak të dyshimit për veprën penale „mashtrim në detyrë“ nga neni 426/2, të KPRK-së"* me arsyetimin se certifikatat e mëhershme në të cilat nuk figuron kjo e dhëna, janë lëshuar me gabime teknike duke shtuar arsyetimin se *„të dhënat në regjistrin e evidencës penale janë regjistruar sipas aktakuzës së lartë cekur me emrin jo sipas letërnjoftimit"*, dhe duke i bashkëngjitur edhe kopjen e aktakuzës si dhe Certifikatën nga Evidenca e Personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë, me numër 5400 të datës 27.03.2018.

Mbi bazën e rrethanave të reja juridike, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 03.05.2018 kishte nxjerrë Vendimin nr.645/2018 përmes të cilit e kishte shfuqizuar Vendimin Nr.172/2018 të datës 15.03.2018 përmes të cilit ankuesja ishte emëruar në pozitën *"Inspektore në inspektoratin për Trashëgimi Kulturore"* dhe po ashtu kishte shfuqizuar edhe aktin e emërimit të datës 16.03.2018 me numër:453, për shkak se të dhënat e ofruara nga ankuesja me rastin e aplikimit në konkursin për pozitën e shpallur, ishin të gabuara apo të pavërteta lidhur me dëshmitë e ofruara-Çertifikatën PN.NR./KR.Br 180/18 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë e datës 05.02.2018 si dhe Çertifikatën PN.NR./KR.Br 15089/17 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë e datës 04.10.2017 sipas të cilave ndaj ankueses nuk është duke u zhvilluar procedurë penale si dhe e njëjta nuk është e dënuar, përderisa me konfirmimin e datës 23.03.2018 nga Gjykatat Themelore e Prishtinës ishte dëshmuar e kundërta, nga rrjedh se ndaj ankuesi ishte duke u zhvilluar procedurë penale dhe kishte të ngritur aktakuzë për shkak të dyshimit për veprën penale *"mashtrim në detyrë"*.

Pas shterjes së mjeteve të brendshme juridike ankimore, me datë 10.10.2018 ankuesja kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 26.09.2018 me

pretendimet ankimore se akti i goditur ishte i paligjshëm dhe se me rastin e refuzimit të ankesës së ankueses, ndërsa lënien në fuqi të Vendimit të datës datë 03.05.2018 me Nr.645/2018 të Sekretarit të Përgjithshëm përmes të cilit ishte shfuqizuar Vendimin Nr.172/2018 të datës 15.03.2018 përmes të cilit ankuesja ishte emëruar në pozitën *“Inspektore në inspektoratin për Trashëgimi Kulturore”* dhe po ashtu shfuqizimit të aktit të emërimit të datës 16.03.2018 me numër:453, kishte bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe bazës juridike.

Këshilli me datë 23.11.2018 kishte nxjerrë Vendimin A.nr.640/2018 me numër protokolli:7112/2018 përmes të cilit e kishte refuzuar ankesën e ankueses të datës 10.10.2018 si të bazuar, ndërsa e kishte lënë në fuqi Vendimin të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 26.09.2018. Pala ankuese kundër vendimit të Këshillit kishte hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, sikurse e njëjta kishte parashtruar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Me pas, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 10.07.2020 ka nxjerr Vendimin me numër:629/2020 përmes të cilit ankuesja është kthyer në pozitën *“Inspektore në inspektoratin për Trashëgimi Kulturore”*, ndërsa në pikën 2 të dispozitiv është përcaktuar se ankuesja punën do të fillojë nga data 10.07.2020, ndërsa me datë 15.07.2020 institucioni i ka lëshuar ankueses Aktin e ri të Emërimit me numër prot:2461/2020/02 të cilin ankuesja e ka pranuar pa ndonjë vërejtje me datë 16.07.2020, gjegjësisht Sekretari i Përgjithshëm vendimin për kthimin e ankueses në pozitën e *“Inspektore në inspektoratin për Trashëgimi Kulturore”* dhe lëshimin e aktit të emërimit e kishte mbështetur ne Raportin e Rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit të datës 27.03.2020.

Ankuesja me datë 05.10.2020 kishte parashtruar kërkesë pranë Sekretarit të Përgjithshëm për kompensim e pagës në mënyrë retroaktive nga data 01.05.2018 kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës deri me datë 10.07.2020 kur edhe ishte thyer në punë sipas vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm me pretendimin ankimore se të njëjtës i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme duke iu referuar Raportit të Rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit të datës 27.03.2020.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, fillimisht me datë 03.02.2021 kishte nxjerrë Vendimin me numër:64/2021 përmes të cilit ankueses ia kishte njohur të drejtën në kompensim retroaktiv të pagës në vlerë pre 14,408.82€, mirëpo me datë 09.03.2021 kishte nxjerrë Vendimin me numër:206/2021 përmes të cilit e kishte plotësuar dhe ndryshuar vendimin e datës 03.02.2021 duke e specifikuar se nga cila kategori buxhetore duhet bërë pagesa, sikurse e kishte hequr pjesën e specifikimin në vendimin paraparak se kompensimi në mënyrë retroaktive është kërkuar me rekomandim të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Po ashtu, me datë 02.06.2021 Sekretari i Përgjithshëm e kishte nxjerr Vendimin me numër:521/2021 përmes të cilit e kishte shfuqizuar Vendimin e datës 09.03.2021 me numër:206/2021 me arsyetimin se kompensimi në mënyrë retroaktive pa vendime gjyqësor nuk mund të bëhet dhe se as Institucioni i Avokatit të Popullit në raportin e datës 27.03.2020 nuk e kishte rekomanduar një gjë të tillë, ndërsa me datë 04.06.2021 Sekretari i përgjithshëm sërish nxjerrë vendimin me numër:540/2021 përmes të cilit e plotëson vendimin e datës 02.06.2021 duke i shtuar edhe përmbajtjen e udhëzimeve juridike-këshillën juridike, ndërsa përmbajtje e diapozitivit mbetet e njëjtë.

Kolegji i Këshillit përpara se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuese, thekson faktin se Vendimi i Këshillit A.nr.640/2018 i datës 23.10.2018 është bërë i ekzekutueshëm, përmes të cilit ishte refuzuar ankesa e ankuses e datës 10.10.2018, ndërsa e kishte lënë në fuqi Vendimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 26.09.2018, ndërsa Gjykatat Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datë 02.12.2021 ka nxjerrë Aktvendimin A.nr.157/2019 përmes të cilit e pezullon procedurën administrative sipas padisë së paditëses kundër Vendimit të Këshillit A.nr.640/2018 të datës 23.11.2018 pasi që ankuesja kishte hequr dorë nga padia me arsyetimin se ishte kthyer në vendin e saj të punës, nga rrjedh se nuk ekzistojnë asnjë aktgjykim i instancave gjyqësore i formës së prerë, mbi bazë e të cilit do të kontestohet ligjshmëria e Vendimit të Këshillit A.nr.640/2018 të datës 23.11.2018 përmes të cilit ishte konstatuar në procedurë administrative se Vendimi i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i datës 26.09.2018 ishte vendim i ligjshëm dhe i drejtë ndërlidhur me veprimet procedurale për shfuqizimin e vendimit të emërimit të ankuses si dhe aktit të emërimit nga ana e organeve të institucionit.

Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 10.07.2020 ka nxjerr Vendimin me numër:629/2020 përmes të cilit ankuesja është kthyer në punë nga data 10.07.2020, ndërsa në pikën 3 të dispozitivit është shfuqizuar Vendimi i datës 03.05.2018 me numër:645/2018, andaj në kuptim të nenin 53 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm"*, rrjedh se ankueses juridikisht nuk i është i njohur asnjë e drejtë tjetër juridike materiale përpara kthimit kohës së kthimit në vendin e punës me datë 10.07.2020.

Po ashtu, referuar nenit 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *"Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi"*, Kolegji i Këshillit thekson faktin se këto dispozita të ligjit jetësohen në rastet e pezullimit parandalues dhe nuk ka të bëjë me kontestimin e procedurave të rekrutimit, ndërsa rasti i ankuses ka pasur të bëjë apo është i ndërlidhje të ngushtë me procesin apo dëshmitë e ofruara me përmbajtje jo të vërtetë apo të gabuar gjatë procedurave të aplikimit në konkursin të cilin më pastaj ishte shpallur kandidat fituese, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuses është i pabazuar.

Andaj, nga administrimi i shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se nuk ekziston asnjë akt administrativ që ka ndërlidhje me ankesën e ankues dhe i cili mund të ketë qenë në fuqi dhe të ketë prodhuar ndonjë efekt juridik pozitiv ndaj palë përpara datës 10.07.2020, ndërsa Vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i datës 10.07.2020 me numër:629/2020 nuk ka fuqi retroaktive, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuses e cila iu referohet dispozitave të nenit 22 të Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil është i pabazuar, dhe mbi këtë bazë si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë, ankesa e ankuses e datës 15.06.2021

është refuzuar si e pabazuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa Vendimi i datës 04.06.2021 me numër:540/2021 i Sekretarit të Përgjithshëm mbetet në fuqi sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, bazuar në këto rrethana dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.536/2021

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses, Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Arkivit të KPMSHCK- së.